

RAMADAN SOKOLI

RRETH MUZIKËS SHQIPTARE NË KOHËN E SKËNDERBEUT

Dihet se muzika, ashtu si të gjitha degët e arteve asht një pasqyrë e zhvillimit të shoqërisë në etapa të caktueme. Tue shfletue botimet e shumta për Skënderbeun, midis atyne pak të dhanave rreth artit e rreth kulturës së asaj kohe, nuk vërehet, mjerisht, ndonjë farë njoftimi për muzikën. As Fan Noli, me gjithë përgatitjen e tij muzikologjike, nuk jep kurrfarë shënimi për të. Sidoqoftë, ne për të mund të parashtrijmë vetëm një syzim panoramik me njohunitë tona të tanishme.

Si kudo nëpër Evropë, duket se edhe në Shqipni, gjatë shekujve XIV-XV muzika pat ngelë mbrapa arteve figurative. Dihet se aso kohe muzika qarkullonte në dy sfera të ndryshme: nëpër faktore e nëpër mungadë (muzika fetare) dhe përjashta këtyne (muzika popullore). Kleri e shfrytëzonte muzikën vetëm për propagandën fetare, kështu që nuk e pranonte krijimtarinë popullore në sferën e vet dhe as që e shikonte me sy të mirë; madje që në shekujt e parë të kristianizmit ishin flakë veglat muzikore nga rrethi i priftërijeve. Çfarëdo muzike jofetare që nuk përshkohej nga fryma mistike, kundrohej nga kleri si mbeturinë e paganizmit, që të josh vetëm për andje dhe që me veshjen e bukur mbulon korrupcionin (sic!)... Prandaj Shën Jeronimi predikonte: «mos të ndigjohen vegla muzikore nëpër shtëpitë e kristianëve! Zbojini muzikantët, besnikët e djallit!... As që duhet ta dinë bijat tueja se ç'asht fyelli, qesteja, harpa...»² Edhe shën Tomas Akuini, ma i madhi teolog i mesjetës (shekulli XIII) dënonte me vendosmëri përdorimin e veglave muzikore, sepse, simbas tij, ndikokan keq në edukimin e rinisë (sic!)³... Kuptohet se në këtë mënyrë kleri pat pengue për një kohë të gjatë zhvillimin e mëtejshëm të muzikës. Por me gjithë fushatat, sulmet dhe ndalesat e klerikëve, prapëseprapë nuk u zhdukën veglat muzikore as nuk shterroi kurrë krijimtaria popullore. Përjashtë kishave populli këndonte me andje kangët e veta në gjuhën amtare, se natyrisht, nuk mund të gazmohej ndër kremtime as nuk shfrente dot harenë e fitoreve me gjuhët e vdekura të kangëve kishtare, — gjuhë të hueja (greqisht, latinisht ose paleosllavisht) dhe të pakuptueshme për të. Mjerisht nga muzika popullore e asaj kohe nuk kemi asnjë dëshmi të shkrueme. Kjo mungesë shpjegohet në radhë të parë me qëndrimin e autokracisë kishtare: në një kohë kur sinodhet kishtare ia ndalonin popullit rreptësisht kremtimet tradicionale të stinëve të motmotit⁴, kush mund të shkruente


1) Fan S. Noli, *George Castrioti Scanderbeg*, New York, 1947.

2) Teresa S. Favara, *La Filosofia della Musica*, Milano, 1940, f. 43.

3) Idem — ibidem.

4) Në aktet e një koncili roman të v. 743 lexohet se «*malkimi ka për të ra mbi cilindo që kremton kalendrat e janarit (et per vicos et plateas saltationes et choros conduca)*».

me notat muzikore të Jan Kukuzelit, ose me ndonjë sistem tjetër jonet e kangëve popullore aq fort t'urrejtuna nga priftërijtë si «turpe», «të filligta», «të ndyta», «sakrilegje» etj.? Ndoshta një farë jehone nga ajo kohë e largët na arrin nëpërmjet shtresave arkaike të folklo-



rit, d.m.th. nëpërmjet disa kangëve ritualistike të kremtimeve vjetore ose të dasmave, që lidhen me doke të lashta e sidomos nga motivet e përbashkëta me arbëreshët e Italisë që shtyhen përtej shekullit XV. Me sa duket, midis kangëve dhe valleve me përmbajtje të ndryshme që shoqnonin jetën e popullit nga djepi deri në vorr, ndiheshin ma tepër balladat dhe ato farë kangësh, që pershkohen nga afshi heroik. Për këto nuk na mungojnë dëshmitë historike.

Për të kuptue ma mirë disa dukuni të asaj kohe, le të vërejmë se ç'vend zinin rapsodët popullorë në shoqin mesjetare. Lidhun me këta faktorë të randësishëm të krijimtarisë popullore lexojmë diçka interesante në një tekst kishtar të shekullit XIII («**Summa de penitentia**») me udhëzime nga nalt për priftërijtë e rretheve: Simbas porosive të këtij teksti u ndalohej e drejta e rrëfimit lavirave, gaztorëve («istriones») dhe rapsodëve që me vegla muzikore argëtonin popullin, — ndonse midis këtyne dalloheshin ata që këndonin për trimnitë e të parëve ose... për jetën dhe veprat e shenjtorëve (këta rapsodë mund të pranoheshin në kishë, të rrëfeheshin dhe të kungoheshin).⁵ Njerëzit e lirë që po kërkonin lumninë në tokë dhe jo në qiell, nën ndikimin e humanistëve, s'po ua vinin fare veshin predikimeve sidomos në ato vise ku sundimi i kishës ishte ba i padurueshëm, atje ku binte ma shumë në sy luksi, lakmia e pangopun, e madje edhe shthurja e klerikëve të shkallës së naltë që shfrytëzonin prona e pasuni toksore të mëdha në kundërshtim me thaniet e Ungjillit. Jashtë faktoreve rapsodët mirëpriteshin nga populli, sepse me aftësitë e tyne, me prirjen e tyne poetike-muzikore gjallnonin kremtimet, dasmat dhe gostitë. Këta bridhnin me torbë e me lahutë në krahë nga një krahinë në tjetrën e futeshin nëpër kështjella e nëpër kulla të vetmueme, ku së bashku me repertorin e tyne u sillnin gjithfarë lajmesh njerëzve që jetonin në ato rrethe të mbylluna. Dikur rapsodët e zbuem nga kleri si «elementë turbullues» filluan me depërtue edhe nëpër oborret e kishave dhe të mungadeve. Për arësye të ndryshme kleri u detyrue dikur të bajë «lëshime» në këtë drejtim dhe të pranojë pak nga pak në gji të vet ata që i kishte luftue pa mëshirë e me aq ngulm. Kështu mund të përmendim si fakt historik pjesëmarrjen e disa muzikantëve me 1395 në panairin e manastirit të Rotecit, natyrisht me lefen e të parëve të fesë!⁶ Historikisht dihet se ç'hov të madh muer ma vonë zhvillimi i artit muzikor me depërtimin e veglave nëpër kishat katolike, ku kleri nuk e përmbante ma dot vërshimin e tyne. Por në atë muzg mesjetar nuk kishte perëndue ende fuqia e fanatikëve me të cilët nuk kapeshin dot mendimtarët e lirë se digjeshin në turrë të druve. Si njerëzit ashtu edhe krijimtaria e tyne ishin nën pushtetin kishtar, prandaj zor se mund të dilnin vepra të shkrueme që binin në kundërshtim me botëkuptimin kishtar. Ja përse të vetmet dëshmi muzikore të asaj kohe i kemi nga repertori fetar.

5) C. Nyrop, *Istriom, trovieri e Giullari*, në «Storia dell' epopea francese nel medioevo», Firenze, 1886, f. 76.

6) G. Gelcich, *Le Zedda e la dinastia dei Balsidi*, Spalato, 1899, f. 181; autr gjithashtu Dr. M. Sufflay, *Die Kirchenzustände im vortürkischen Albanien* — Zagreb 1915.

Mbarimi i shekullit XIII shënon në historinë e melurgjisë bizantine një periudhë dekadence. Pikërisht nga ajo kohë kemi disa dorëshkrime me vlerë të madhe për historinë e traditës sonë muzikore: — Kur mërguen arbëreshët së këndejmi për t'u vendosë në Italinë Jugore, morën me vehte disa visare liturgjike. Pavarësisht nga koha e shpërnguljes së arbëreshëve (shekulli XV-XVI) duket se shumica e atyne kangëve i përkasin mbarimit të shekullit XIII dhe përfaqësojnë një burim të gjallë për historinë e melurgjisë bizantine⁷, prandaj kanë terhekë vëmendjen e shumë muzikologëve.

Nga prania e organos nëpër kishat e Shqipnisë Veriore mund të mendojmë se nuk duhet të kenë mungue mjeshtrat organistë që i binin kësaj vegle, si dhe repertori përkatës përveç koreve «a Capella».

* * *

Dihet se zhvillimi i muzikës përkon me zhvillimin e mjeteve të shprehjes muzikore.

Si paraqitet gjendja e këtyne mjeteve në kohën e Skënderbeut ose ma mirë: çfarë veglash muzikore përdorëshin aso kohe këtu në vendin tonë?

Pyetja e masipërme prek një degë të randësishme të kulturës sonë. Për t'ju përgjegjë kësaj pyetje mund të shfrytëzohen disa burime historike, letrare, ikonografike etj. Së këndejmi nxirren njoftime të çmueshme si mbi veglat muzikore të kohës në fjalë ashtu edhe mbi gjendjen shoqnore të viseve ku përdorëshin ato, mbi kushtet e zhvillimit, mbi marrëdhëniet kulturele etj. Së pari kemi veprën e njoftun të shkodranit Marin Barleci, — jetëshkruesi bashkëkohës i Skënderbeut (*Historia de vita et gestis Scanderbegi* etj.) që thotë diçka edhe për veglat muzikore të asaj kohe. Në librin VI f. 282 të veprës në fjalë, aty ku përshkruhet hareja mbas njenës nga fitoret e shumta të Skënderbeut, lexojmë midis të tjerash: «Gëzimi i zemrave shpërtheu sa mundi më tepër me brohori me kangë dhe me gjithfarë veglash, as gjëmimi këmbanave (nënvizoi — R.S.) as zjarret e ndezur e të pashuar tërë natën s'pushuan për shumë ditë».⁸ Ndërsa në librin IX ku përshkruhet kthimi i Skënderbeut në Krujë mbas një fitoreje tjetër lexojmë: «Ne mes të brohoritjes së njerëzve dhe zhurmës së veglave arritën në qytet me një gëzim aq të madh sa që zor të bahëj triumf më i bukur dhe paradë më madhështore».⁹

Dy njoftimet e masipërme paraqesin interes për organografinë tonë, ndonse nuk cilësojnë se çfarë veglash ishin ato. Në librin III Barleti thotë shprehimisht: «Zhurma nga të katër anët e ushtarëve të armatosur dhe buçitja e burijave...» («clangor tubarum» në origjinalin latinisht)¹⁰, kurse në librin VI, f. 253 thuhet: «Boriet buçitnin me të

7) Lorenzo Tardo, *L'antica melurgia bizantina*, Grottaferrata, 1939, f. 111.

8) Marin Barleci: *Historia e Skënderbeut*, përkthyer nga Stefan I. Prifti, Tiranë 1964.

9) Idem — ibidem f. 37.

10) *Po aty*, f. 143. Barleti na jep mjerisht vetëm në latinisht emërtimin e veglave por tue përshkrue deri diku edhe vetë cilësitë buçitëse («clangor») të tingujve.

madhe e burrat bërtisin dhe po marshonin në drejtim të mureve» 11. Pastaj në librin X Barleti thotë kështu: «Nga ana e arbërorëve buçitën boriet dhe trumbetet» (origjinali latinisht f. 300 e ka kështu: **tubae cornuaque ab Albanis cecinerunt**).¹² Emri «bori»¹³ në gojën e popullit tonë vështron përgjithësisht vegël frymore por, nga ky përgjithësim i përkthyesit asht e vështirë të kuptohet se për cilën vegël bahet fjalë. **Tuba** dhe **korni** që përmend Barleti ishin dy vegla aerofone që përdorshin për sinjale nga kambësoria dhe nga kalorësia goftë në luftë, goftë në parakalime ose nëpër mbledhje solemne. E para përbahej nga një gyp metalik pothuase i drejtë (këtë trajtë dhe këtë emën **tuba** e pat riejtë nga koha e lashtë); kurse «**korni**» që përdoret edhe sot nëpër disa vise të Shqipërisë Jugperëndimore me emnin «**bobël**» përbahet nga brini i kafshëve të trasha ose nga guaska e kërmillit të detit. Me një vegël të këtillë të varun në brez na paraqitet Skënderbeu në pikturën e një auktorit të panjoftun. Shtojmë se në disa vende boblën e zavendësoi me kohë **buria saracineske**.

Krahas burimeve historike kemi ikonografinë e Mesjetës që na jep disa të dhana për veglat muzikore, ndonse paraqitja e tyne në pikturat bizantine ishte shumë e kufizuese, sepse, siç u tha, kisha ortodokse nuk i përdorte as nuk lejonte të përdorshin vegla të këtilla në liturgjinë e saj. Megjithatë në ikonografinë tonë nuk mungojnë skenat karakteristike ku mund të vërehen edhe vegla muzikore. Kemi p.sh. një ikonë të shek. XIV nga kështjella e Beratit (sot ruhet në muzeumin arkeologjik të Tiranës) në të cilën shihet një fëmijë tue i ra **gloriskës** (vegël fryme që sajohej nga korja e drujve). Po kjo vegël shihet edhe në një ikonë të piktorit elbasanas Onufri (shekulli XVI po n'atë muze). Duket se modelet për të vizatue këtë vegël janë marrë nga vetë tradita popullore, siç dëshmojnë figurat e afreskeve me barij fyelltarë, të pikturueme nga Onufri ynë në një kishë të Kosturit.¹⁴ Kuptimplotë asht fakti se veglat e masipërme janë shfrytëzue nga auktorët e këtyne pikturave si shprehje hareje për skena të «Lindjes së Krishtit».


Në një pikturë të shekullit XVI pranë portretit të Skënderbeut shihen në sfond, midis plaçkave të luftës, tytat e dy zurnave. Duket se kjo vegël e gjinisë aerofone me tytë druni në trajtë cilindronike dhe me pips të dyfishtë na ka ardhë rreth mbarimit të mesjetës nga Lindja e Mesme (siç dëshmon etimologjia persishte e emnit të saj), ndoshta para pushtimit otoman, meqë e kanë edhe arbë-

11) *Po aty*, f. 409.

12) Në përkthimin shqip të veprës së masipërme të Barleci çeket disa herë emni «bori», edhe kur auktorit nuk cilëson ndonjë vegël të veçantë; p.sh. në librin III, f. 167 lexojmë: «Dha me njëherë urdhër *t'u binin borijeve* (përkthye lirisht nga origjinali «*Signa canere jubet*» f. 96); gjithashtu në librin V, f. 215, lexojmë: «Shumë nga tanët po i ndiqnin këmba këmbës e s'po u ndaheshin gjersa *ra boria*» (kurse origjinali f. 136 e ka tekstualisht «*receptui dato*»). Në të dy rastet kemi një figurë për mbledhjen e njerëzve nëpërmjet ndonjë zadhanësi, por pa cilësue shprehimisht ndonjë vegël. Gjithashtu në rastin e maposhtëm: «*Skënderbeu ... duke urdhëruar që boria të jepte shenjën e terheqjes dhe që ushtarët e tij të pushonin betejën*» (Libri X f. 403).

13) Ky emën me etimologjinë turke duket se do të ketë hy në gjuhën tonë para pushtimit osman, ose që në përpjekjet e para me turqit, meqë e kanë edhe arbëreshet e Italisë Jugore, të cilët, siç dihet, u shpërngulën së këndejmi në shek. XV-XVI. Sa për kronologjinë e këtij emni në shqipe, shtojmë se për të parën herë e gjemë të botuem të vepra e Bogdanit «*Cuneus prophetarum*».

14) Pelikanidhes, *Kastoria*, II, Selanik, 1953 f. 92 dhe 237.



reshët e Italisë («Zhurna»). Sa për kronologjinë e emnit të kësaj vegle në shqipe, si gjurmën me të vjetër tash për tash e kemi te fjalori i Frang Bardhit («curlë», «zurnë», «surlë»).¹⁵

Njoftime të çmueshme për veglat muzikore që përdorte populli ynë aso kohe na japin edhe shënimet e udhëtarëve që kaluen nëpër vendin tonë. Një farë Gjovani Sforca, i cili në vitin 1575 udhëtoi nëpër luginën e Drinit, thotë se në këto vise përdorej një vegël membranofone («tupani») për të kumtue lajme nga një fshat në tjetrin: «S'udiva per quelle montagne il strepito d'un taburino era avviso alli abitatori che passava gente assai e chi lo batteva appena ci pareva un uccello»¹⁶. Për vegla membranofone të këtilla kemi edhe dëshmi ikonografike të epokës paraturke: në një afresk të kishës së Deçanit (1327-1348) që ndodhet pranë grykës së Drinit të Bardhë, midis Pejës dhe Prizrenit, vërehen dy tumbullacë të vendosun për tokë. Detarët e vendit tonë përdorshin dikur vegla membranofone të këtilla për të njajtin qëllim, siç dëshmon tradita gojore, e sidomos ballada popullore e rrëmbimit të nuses përtej detit. Shtojmë se simbas gojëdhanave matjane, banorët e Macukullit (Norcat) paskan qenë «**dajrexhinjtë e Skënderbeut**».

Njoftime të çmueshme për veglat muzikore që përdorshin në vendin tonë gjatë shekullit XIV nxjerrim gjithashtu nga relacionet e misjonarëve. Pjetër Bogdani në relacionin e tij të vitit 1685 shkruente se në oborrin e dytë të kështjellit Rozafat mbrenda xhamisë që dikur pat qenë kisha e famshme e shën Shtjefnit, pa një **organo** të prishun («organo disfato») që turqit e mbanin si kujtim ose si plaçkë lufte.¹⁷ Kjo vegël përdorej edhe nëpër banesat e fisnikëve të shekullit XIV, por me përpjesëtime të vogla, pak a shumë si një kuti që mbahej në gju me nga 20 taste e tyta. Kurse organot e palëvizshme të faltoreve ishin të pajisuna me pedaljerë e me disa qinda gypash të grupuem në sisteme timbrike.

Po nga gjinia idiofone çfarë veglash përdorshin në kohën e Skënderbeut?

U pa ma nalt se Barleci (Liv. VI, f. 282) përmend edhe **Kumonët** që aso kohe ishin shumë të përhapuna. Dihet se që në kohet e vjetra kemi pasë punishte kumonësh në Ulqin (shek. XV), në Lundrea (sot fshat i vogël afër Pishkashit) etj. që vende-vende arritën deri në shekullin XVI. Një ndër mbeturinat e fundit të këtyne punishteve asht kumona që ndodhet në veriperëndim të fshatit Shelbe (Mirditë), e cila e ka të shënueme datën e derdhjes së saj (1559). Vlen të theksohet se me anë të kumonëve lajmëroheshin burrat për të marrë pjesë në mbledhjet dhe në kuvendet popullore.¹⁸ Kumonët përdorshin edhe për kushtime në raste rreziqesh: kur sulmonin hordhitë turke në kufijtë e Shqipnisë, shungullonin kumonët fshat më fshat tue përçue lajmin deri në Krujë.¹⁹ Simbas gojëdhanës popullore, vetë Skënderbeu i binte me andje kumonëve të ish-kishës së Lleshdrit. Thuhet se

15) Franciscum Blanchum, *Dictionarium Latino-Epiroticum*, Romë, 1635.

16) Giovanni Sforza, *Un viaggio attraverso i Balcani nel 1575*, Siena, 1915.

17) Theiner, *Vetera Monumenta Slavorum Meridionalium*, Zagabriae, 1875, vëll. II f. 218.

18) Dr. M. Sufflay, «Städte und Burgen Albaniens hauptsächlich Während des Mittelalters», Vjenë 1924.

19) Kemi të dhana edhe nga shekulli XIII për kumonë alarmi në banesën e komandantit të kështjellës së Durrësit (shih Ljubic: Listine IX-131).

një herë Mamica, motra e heroit tonë, kërkoi nga i vëllai që t'i falte «aq tokë sa përfshinte tingulli i një kumone». Të nesërmen, kur po shëtitnin së bashku, ndigjuen nga mali i Bazës ushtimën e kumonëve të Jubës²⁰; në atë çast Skënderbeu i dhuroi së motrës të gjitha tokat e Arbënit²¹. Në këtë gojëdhanë vlen të nënvizohet si diçka interesante shfrytëzimi i tingujve si njisi matëse për hapsinën. Mbas pushtimit osman u ndalua për disa kohë përdorimi i kumonëve; kështu që prifritjtë e shumë viseve të Rumelisë i ftonin besimtarët në kishë me anë të **trokës**. Kjo vegël që përdoret edhe në shekullin tonë nëpër kishat ortodokse, veçanërisht në javën e pashkëve, kur kumonët heshtin në shej zije, përbahet nga një dërrasë ose pllakë metalike e varun në tra: tue e goditë me çekiça, nxjerr një farë shungullime idiofone.

Përveç kumonëve dhe trokëzave gjatë shekullit XV përdorehin edhe këto farë veglash idiofone të trashëgueme nga kohët e lashta: **tingingu** («sistro»), **gërreza**, **trakthimza** dhe **xhingrrat** për valle (lat. «nolae»).²²

Tue vazhdue parashtrimin tonë me veglat e gjinisë kordofone që përdorehin në vendin tonë gjatë asaj kohe, mund të përmendim **buzukët** dhe **tamrrat** e ardhuna nga Orienti, ndoshta nëpërmjet kryqëzatave, qesten («cister») dhe kanunin («salterio» ose «symbalum») të ardhuna gjithashtu nga Lindja dhe që u përhapën në Evropën Perëndimore nëpërmjet Ballkanit, dhe sidomos **laurinë** (λύρα) e kronistëve bizantinë të shekullit IX) e **lahutën** të ardhuna gjithashtu nga Lindja e Mesme siç na dëshmojnë studimet e reja etnomuzikologjike.²³ Duket se me këto dy veglat e fundit, që shihen në afreskun e kishës së Deçanit dhe që edhe sot gëzojnë dashurinë e malësorëve tanë shoqëroshin kangët epike.²⁴ Këtu nuk do të zgjatemi rreth rolit politik që luejtin këto vegla në vetëdijen e popullit tonë, tue përjetësue nëpërmjet kangëve historike, trimnitë e herojve, por do të ndalemi pak rreth një motivi plastik që daltojnë mjeshtrit popullorë në bishtin e lahutës: d.m.th. rreth kokës së dhisë që vërehet ma shumë se çdo zburim tjetër. Ende nuk mund të themi në se kemi të bajmë me mbeturinën e ndonjë kulti të lashtë totenik apo me një zburim të rëndomtë. Sidoqoftë, shkoqitja që japin disa nga malësorët tanë për këtë figurë plastike asht mjaft interesante: simbas tynë, koka e dhisë në bishtin e lahutës paraqet në mënyrë simbolike heroin tonë kombëtar nëpërmjet motivit zoomorf të përkrenares së tij, prandaj veglat me daltime të këtilla i quejnë «lahutë me Skënderbeg».

Veglave që u parashtruen, duhet t'u shtojmë edhe **pipzat**, **fyejtë** (me ose pa sqep), **biculën**, **gajdën**²⁵ e të tjera trashigime të lashta për

20) Thuhet se Juba ka pasë aso kohe kumonën më të madhe në të gjithë Arbënin.

21) M. Sirdani, *Skanderbegu mbas gojëdhanash*, Shkodër, 1926, f. 69-70.

22) Shih R. Sokoli, *Veglat muzikore të popullit shqiptar*. Botim i shtëpisë qëndrore të krijimtarisë popullore, Tiranë 1966.

23) Shih Werner Bachmann, *Die Anfänge des Streichinstrumentenspiels*, Leipzig, 1964.

24) Përveç dëshmime ikonografike edhe të dhanat gjuhësore provojnë se lahuta përdorej nga populli ynë para pushtimit otoman: fjalën «lavutë» e kanë edhe arbëreshët e Italisë.

25) L. von Thalloczy, *Beiträge zur Siedlungsgeschichte der Balkan-halbinsel* në «Illyrisch-Albanische Forschungen», München und Leipzig, 1916 — I — f. 21.

të cilat nuk mungojnë dëshmitë arkeologjike dhe që tue u pershkue nëpër Mesjetë vazhdojnë të përdoren edhe sot nga populli ynë.²⁶

Simbas njohunive tona të tanishme, këto pra ishin veglat muzikore që përdorshin në vendin tonë gjatë kohës së Skënderbeut. Pa dyshim, përveç këtyne njoftimeve, mund të gjinden edhe të dhana të tjera kur të hulumtohen mirë të gjitha burimet e shkrueme, të pikzue me ose të skalituna: Ndonse për këtë punë nuk janë shfrytëzue ende të gjitha të dhanat dokumentare,²⁷ prapëseprapë edhe me kaq sa u parashtrua bindemi për atë shprehjen e Barlecit që thotë me të drejtë se përdorshin «gjithfarë veglash».

Nuk mund të merremi në këtë syzim me historikun dhe prejardhjen e gjithë këtyne veglave, disa prej të cilave u braktisën me kohë e nuk përdoren ma nga populli ynë, por theksojmë se në këtë udhëkryq midis Lindjes dhe Perëndimit, ku ndeshen traditat e lashta të kulturës mesdhetare me ato të Lindjes së afërme, gjatë shekujve XIII-XV vërehen mjaft ndikesa arabo-persjane ashtu si në krejt sferën bizantine. Këndeji pra kaluen disa farë veglash muzikore, që shtegtuen nga një kontinent në tjetrin për t'u përhapë nëpër viset e Evropës.

Na mbeten për të ba edhe disa vrojtme plotsuese.

Si përdorshin gjithë këto farë veglash muzikore, veç e veç apo edhe në grupe orkestrale? — Nuk kemi dëshmi bindëse për t'i dhanë përgjigjen e saktë kësaj pyetjeje, megjithatë hamendojmë se në ato rrethana zor se mund të kemi pasë kushte të volitshme për orkestra. Nuk duhet harrue edhe pengesat që i sillte kleri përdorimit masiv të veglave muzikore të cilat i kundronte si «mjete të djallit si ngacmuese të epshit». Sot për sot nuk dimë asgja rreth repertorit të këtyne veglave, meqë gjatë mesjetës nuk shkruhej kurrfarë muzike instrumentale. Mungesa e dëshmive të mjaftueshme na detyron të shfrytëzojmë edhe burimet kishtarë, ndonse, po të mbështetem vetëm te ato, nuk nxjerrim dot përfundime shumë të sakta. Sado të vlefshme që të jenë të dhanat ikonografike, ato nuk arrijnë për një paraqitje të plotë rreth veglave muzikore. Tue shikue me vëmendje p.sh. ilustrimet e episodeve biblike vërehen disa anakronizma si f.j. vj. **lira**, **harpa** e të tjera vegla të lashtësisë pranë veglave mesjetare. Edhe përjashta faltoreve kemi pak a shumë ngatërresa të këtilla: në shënimet e kronistëve bizantinë përmenden rëndom veglat muzikore, por në mënyrë të atillë që zor se mund të kuptosh me përpikmëni se për çfarë veglash bahet fjalë sepse shpesh herë me të njajtin emën quejnë vegla krejt të ndryshme si p.sh. me emnin «**kithara**» quejnë edhe «**psalterin**» me 10 tela edhe «**tamburatë**».

Si përfundim theksojmë se gjithë këto farë veglash muzikore që përdorte populli ynë në kohën e Skënderbeut nuk shërbenin vetëm sa për të argëtue ndigjuesit por, siç u pa gjatë parashtrimit, ato luejtën një rol të randësishëm si mjet kushtrimi në raste rreziqesh, tue

26) Për një përshkrim ma të hollësishëm të shumicës së këtyne veglave shih R. Sokoli, ibidem.

27) Një tjeëndje ende e pa kënaqshëme për këtë degë verehet edhe nëpër viset e tjera: në kongreset ndërkombëtare të muzikologjisë së këtyne viteve të fundit, disa kumtues tërhoqën vëmendjen e shkencëtarëve rreth mbrapambetjes së organografisë në humultimin e instrumentariumit të sferës bizantine (shih Emanuel Wurternitz, *Die bildende Künste als Quelle für der Musikhistoriker*, në «Raport of the eighth Congress», Kassel, 1961, vëll. I).

u dhanë zemër luftëtarëve ndër beteja, tue shtue harenë e fitoreve dhe tue kallë ma tepër afshin e lirisë nëpërmjet kangëve epike që naltësojnë shembullin e herojve.

Résumé

SUR LA MUSIQUE ALBANAISE AUX TEMPS DE SKANDERBEG

Dans l'Albanie médiévale, notamment durant les siècles XIV et XV, comme dans tous les autres pays d'Europe d'ailleurs, la musique signait le pas derrière les beaux-arts. A cette époque la musique circulait en deux sphères: dans les églises et les couvents (la musique religieuse), et, en dehors de ceux-ci, la musique populaire. Le clergé utilisait la musique pour ses propres buts. Il n'admettait point la création populaire dans sa sphère et ne l'a pas même considérée d'un bon oeil, faisant obstacle pour longtemps à son développement. Malgré ces efforts de l'église, les instruments populaires n'ont point disparu, la création populaire n'a pas tari. Le peuple chantait avec plaisir ses propres chansons.

Sur la musique populaire des temps de Skanderbeg il n'y a pas des documents. Un certain écho de ce temps lointain nous arrive à travers les couches archaïques du folklore, c'est-à-dire à travers certains motifs ritualistiques des festivités de l'année ou des noces, qui se rattachent à des coutumes anciennes, et notamment à travers les motifs communs avec les Albansais d'Italie, qui remontent antérieurement au XIV^e siècle.

On sait que le développement de la musique concorde avec le développement des expressions musicales. C'est précisément l'état de ces moyens d'expression qui peut parfaire notre représentation sur la musique de l'époque de Skanderbeg. Les renseignements sur les instruments de musique de ces temps sont tirés de quelques sources historiques, littéraires et iconographiques. De leur nombre, la première place va à l'oeuvre de Barletius, où il est question des cloches, du bruit des instruments, du résonnement des clairons.

Quoique la reproduction des instruments de musique sur les icônes soit limitée, aussi dans celles-ci on peut repérer des éléments précieux. Ainsi, sur une icône du XIV^e siècle du château fort de Berat (actuellement dans les collections du Musée d'Archéologie de Tirana), on discerne parfaitement un enfant jouant de la gloriske (un instrument à vent formé par l'écorce des plantes). Le même instrument est discerné aussi sur une icône du peintre d'Elbasan, Onufre. Ces modèles sont empruntés à la tradition populaire.

Des renseignements précieux donnent à cette intention aussi les notes des voyageurs qui ont parcouru notre pays. Ainsi, un certain Giovanni Sforza (1575) parle d'un instrument membranophone (le tupan), utilisé à communiquer les nouvelles d'un village à l'autre.

Les relations des missionnaires nous offrent également plusieurs notes. Pjetër Bogdani, dans une relation de 1685 parle de l'orgue et de son utilisation dans les habitations des aristocrates.

En dehors des cloches et d'autres instruments du XV^e siècle, étaient en usage aussi les instruments idiophones suivants, hérités de l'antiquité: le tingting (le sistre), gerreza, trahthimza et xhigrrat pour danses (en lat. «nolae»). Comme instruments cordophones on peut mentionner les buzuke, tamrra, provenant de l'Orient, la qeste («cister») et le hanun (cymbale), provenant de l'Orient, et notamment la lauri et la lahute, provenant également du Proche-Orient. Aux instruments mentionnés ci-dessus on peut ajouter aussi les pipëz (mirliton), fyell (flûte), bicule et la gajde (cornemuse).

Sur leur utilisation on n'a pas des données. On ne sait rien également sur le répertoire de ces instruments.

